



Prishtinë: 02.09.2021
Kodi i ZRRE-së: V_1375_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_2177_05_21 i dt.28.05.2021**;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **02.07.2021**.

në seancën e mbajtur më datë **02.09.2021** nxori këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin R.N nga Komuna e Prishtinës, me shifër të konsumatorit DPR - 33576, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me nr. ZRrE/DMK_V_2177_05_21, i datës 28.05.2021.

A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 28.05.2021, ka marrë vendim me të cilin është aprovuar pjesërisht ankesa e konsumatorit R.N nga Komuna e Prishtinës dhe është obliguar KESCO që ta anulojë korrigjimin me nr.94324DPR –33576 të datës 16.05.2019 në vlerë financiare prej -139.67 EUR. Po ashtu, KESCO është obliguar që këtë korrigjim ta bëjë sipas shpenzimeve të regjistruara në periudhën 12/2019 deri në periudhën 02/2020, kurse korrigjimi i periudhës 11/2018 mbetet i pandryshuar.

Kundër këtij vendimi në afatin ligjor ka paraqitur Kundërshtim i licencuari KESCO, për shkak se:

- Departamenti për Kujdes ndaj Konsumatorëve në KESCO ka konstatuar se korrigjimi i dt. 16.05.2019 është në përputhshmëri të plotë me rregullat në fuqi, pasi që energjia e shpenzuar nga shifra DPR – 33575 është regjistruar në njehsorin e kësaj shifre dhe kjo energji është zbritur në shifrën DPR – 33576 për aq sa është shpenzuar në shifrën e mëparshme;
- ZRrE vendimin e saj e arsyeton në rrjedhën e energjisë elektrike;
- Përderisa shifrat DPR 33576 dhe DPR 33575 secila ka pasur të vendosur njehsorin e tyre dhe energjia elektrike është matur përmes njehsorëve, ka qenë e mundur që të konstatohet saktë energjia e shpenzuar tek shifra DPR 33575 e cila është faturuar si energji e dyfishtë;
- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRrE-së pezullimin e Vendimit ZRrE/DMK_V_2177_05_21 të dt.20.01.2021.



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pikën e kundërshtimit të KESCO-s në të cilën pretendohet që korrigjimi i dt.16.05.2019 është në përputhje me rregullat në fuqi, Bordi i ZRrE-se pas analizimit të Rrjedhës së Energjisë Elektrike me njehsorin e vjetër elektrik dhe me njehsorin e ri elektrik, ka konstatuar se konsumatori ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese si dhe të mëhershme me njehsorin e vjetër elektrik nr.40862258 dhe njehsorin e ri elektrik nr.43112639 për periudha të njëjta kohore, Bordi ka konstatuar se konsumatori ka ndryshim të shpenzimeve përkatësisht ka rritje të shpenzimit. Po ashtu edhe bazuar në analizën e procesverbalit të inspektimit nr.0702683 të datës 14.02.2019 vërtetohet se njehsori nr.43112639 i vendosur për matje **ka bërë regjistrimin e shpenzimeve për dy shifrat, e që kjo është në kundërshtim me nenin 28** paragrafin 1, 2 dhe 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, ku thuhet se: *1. Furnizuesi është i detyruar të sigurojë që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar r dhe për tarifën tjetra, sipas strukturës tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës të dakorduar me Konsumatorin (nëse është e aplikueshme), 2. Faturimi i energjisë së shpenzuar zbatohet për çdo periudhë të faturimit duke u bazuar në të dhënat e lexuara nga njehsori dhe të mbledhura nga Operatori i Sistemit ose Furnizuesi ashtu siç është rënë dakord në kontratën për furnizim, ose me tarifa të miratuara nga Rregullatori për konsumatorët që gëzojnë të drejtën e shërbimit universal dhe furnizuesit të mundësisë së fundit dhe 3. Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktajnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”,* por që konsumi i faturuar për periudhën 12/2018 dhe 01/02/2019 nuk paraqet shpenzim real të konsumatorit.

Lidhur me pretendimin tjetër se DMK si shkallë e parë vendimin e saj e bazon në rrjedhën e energjisë elektrike, Bordi thekson se rrjedha e energjisë elektrike është një nga provat më esenciale në procedurën e zgjidhjes së ankesave të konsumatorëve në sektorin e energjisë, pasi që na mundëson që të kemi një pasqyrë të qartë të konsumit dhe profilit të një konsumatori në përgjithësi. Gjithsesi, krahas rrjedhës së energjisë, Bordi ka analizuar me kujdes edhe procesverbalet, faturat dhe dokumentet tjera relevante si në shkresat e lëndës.

Po ashtu, Bordi ka shqyrtuar edhe korrigjimin plotësues të dt. 16.05.2019 të bërë nga Departamenti i Faturimit në KESCO dhe ka konstatuar se KESCO ka vepruar bazuar në nenin 28 paragrafin 3 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji ku thuhet se: *Në rast të gabimeve që rrjedhin prej të dhënave të leximit të pasaktë të njehsorit, të cilat shkaktajnë faturim të pasaktë, Furnizuesi do të bëjë të gjitha korrigjimet (rregullimet) e nevojshme në faturën vijuese”.* Por që në rastin e konsumatorit **vërehet se ka ndryshim në shpenzim të energjisë elektrike** për periudhat e njëjta 12/2019 - 02/2020 andaj DMK konstaton se konsumatorit duhet t'i bëhet korrigjimi sipas shpenzimeve të regjistruara në periudhën 12/2019 deri në periudhën 02/2020 kurse korrigjimi i periudhës 11/2018 mbetet i pa ndryshuar.



Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 02.09.2021 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Vendimi iu dërgohet:

- KESCO-së,
- Konsumatorit R.N. dhe,
- Arkivit të ZRRE-së

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Buçaj, anëtar